



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI

Tiranë, më 30.12.2012

Njoftim për Shtyp

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI
DREJTUESIT E NDËRMARRJES UJËSJELLËS-KANALIZIME MAT**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 986/2, datë 6.9.2012, ka ushtruar auditim në shoqërinë “Ujësjellës-Kanalizime” Sh.A., Mat. në lidhje me aktivitetin ekonomik e financiar të kësaj shoqërie, ku nga ana e grupit të auditimit u konstatuan një sërë shkeljesh dhe parregullsish ligjore në lidhje me administrimin e investimit të kryer me kontribut të Qeverisë Norvegjeze për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza.

Nga auditimi rezultoi që drejtori dhe shefat e financës (sipas periudhave) të kësaj ndërmarrjeje, nuk kanë regjistruar në kontabilitetin e shoqërisë të gjitha mallrat e ndodhura në magazinën e marrë në dorëzim në përfundim të punimeve nga Projekti Norvegjez; kanë kryer një sërë daljesh drejt subjekteve të ndryshëm fizikë dhe juridikë (në disa raste edhe ndaj subjekteve private), për të cilat mungojnë dokumentet justifikuese dhe vërtetuese për përdorimin e materialeve të bëra dalje, si dhe kanë nxjerrë urdhërat për këto dalje; të gjitha këto veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me Ligjin nr. 9228 datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, me Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe me VKM nr. 783, datë 22.10.2006 “Për standardet dhe rregullat e kontabilitetit”.

Dëmi financiar i llogaritur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si pasojë e këtyre veprimeve të kundërligjshme është 18,628,898 lekë, i cili përfaqëson daljet në vlerë të materialeve nga magazina për periudhën 4 vjeçare 2007-2011, ku për të gjitha rastet mungojnë dokumentet justifikuese dhe vërtetuese për përdorimin e këtyre materialeve.

Për të gjitha shkeljet e mësipërme janë ngarkuar me përgjegjësi dhe është çuar kallëzim penal për drejtorin i shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” SH.A, Mat, kryetarin e Degës Teknike të shoqërisë, kryetarin e Degës së Financës në shoqërisë, dhe dy ish-kryetaret e Degës së Financës në shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime”; të cilët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre funksionale, kanë kryer me dashje veprime dhe mosveprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

Për të gjitha veprimet e mësipërme i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.